



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 11.09.2025

Numër Protokolli: 6104/2025

A.nr.1304/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1304/2025, të datës 07.07.2025, të parashtruar nga ankuesja G.M-K, kundër organit të punësimit: Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, më datë 11.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa numër A.nr.1304/2025, e datës 07.07.2025 e parashtruar nga ankuesja, G.M-K.

II. Detyrohet Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ekzekutoj kompensimin financiar sipas Vendimit më numër protokolli 310, të datës 29.08.2024, të Menaxherit të Personelit, në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile G.M-K, (në tekstin e më tejme referuar: *Ankuesja*), më datë 07.07.2025, përmes postës elektronike ankesa.kpmshck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin, për shkak të heshtjes administrative të organit të punësimit, lidhur me kërkesën e datës 21.01.2025, për shkak të mos të mosekzekutimit të pagës jubilarë në shumën prej 450.30 Euro, nga Thesari i Kosovës, sipas Vendimit me numër protokolli 310, të datës 29.08.2024, të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa, kjo fundit, ky i fundit, më datë 21.07.2025, ka përcjell shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 4527/2025, të datës 07.07.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.310, të datës 29.08.2024; Njoftimin e datës 10.12.2024; Kërkesën e datës 21.01.2025; Kopjen e letërnjoftimit; Formularin e parashtrimit të ankesës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 16.07.2025; Përgjigjen në ankesë së bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i punësimit të datës 21.07.2025; Shkresën e emërimit të datës 10.10.2022; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 20.03.2024; Listën e pagave; Vendimin me numër protokolli 5565/2025, të Kryetarit të Këshillit.

Kolegji i Këshillit pasi shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur së ankesa e ankueses është e **bazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovë dhe se i njëjta ushtron pozitën e punës Zyrtar e Personelit në Qendrën Korrektuese në Lipjan. Tutje, nga provave materiale të kësaj çështje del se ankuesja me datë 11.06.2024, ka parashtruar kërkesë për kompensimin e pagës jubilarë tek Menaxheri i Burimeve Njerëzore të organit përkatës të punësimit, ndërsa, ky i fundit më Vendimin më numër protokolli 310, të datës 29.08.2024, ka aprovuar kërkesën e ankueses të datës 11.06.2025, duke i njohur të drejtën e kompensimit për pagë jubilarë rrjedhimisht për 20 vite përvojë pune dhe atë në vlerën e përgjithshme financiare prej 450.30 Euro. Sipas thënieve në ankesë, ankuesja asnjëherë nuk ka pranuar këtë kompensim, pasi që nuk ishte ekzekutuar nga Thesari i Kosovës, ndërsa, e njëjta edhe më datë 21.01.2025 i është drejtuar organit të punësimit me kërkesë për kompensim, mirëpo sipas provave të çështjes rezulton se nuk ka pranuar përgjigje në kërkesën e saj, po ashtu SHKK-ja në përgjigje në ankesën e ankueses nuk ka dhënë asnjë sqarim apo prove që arsyeton mos ekzekutimin e kompensimit për shpërblimin e dyle jubile të aprovuar nga organi i punësimit.

Ankuesja më datë 07.07.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi pretendimin ankimor për realizimin e të drejtës materiale në realizimin e kompensimit të pagës jubilarë në shumën prej 450.30 Euro, nga Thesari i Kosovës, sipas Vendimit me numër protokolli 310, të datës 29.08.2024, të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar.

Në kuptim të statusit ligjor të të punësuarve në Shërbimin Korrektues, Kolegji i Këshillit i'u referua nenit 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët ku përcaktohet: "1. *Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues.... 2. Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. trajnimet dhe zhvillimin profesional; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve; 2.6. përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimin. ..*" dhe si pasojë e këtij përcaktimi ligjor Këshilli ka kompetencë lëndore për trajtimin e kësaj çështje juridike-administrative.

Rrjedhimisht, duke qenë së e drejta e ankueses në pagë jubilar ka lind më datë 19.08.2022, pasi që sipas Vendimit më numër protokolli 310, të datës 29.08.2025, të Menaxheri të Personelit të SHHK, me datë 19.08.2022 ankuesja ka arritur 20 vite përvojë të vazhdueshme pune në SHKK, Kolegji thekson faktin së në këtë periudhë ka qenë i aplikueshëm Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil i cili me nenin 22 paragrafi 2 ka paraparë: *Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim: 2.1. pagesën për rastet kur janë tepricë nga puna; 2.2. pagesën për shkak të pensionimit; 2.3. shpërblimi i përvjetorit (jubile),* ndërsa,

Rregullorja Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet e Tjera më nenin 21 përcaktonte: *Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune.* Andaj, mbi bazën e këtij përcaktimi ligjor, Kolegji erdhi në përfundimin së Njësia e Personelit të SHKK-së më të drejtë i ka njohura ankueses të drejtën e shpërblimit të dytë jubile, dhe së në rastin konkret kërkesa e ankueses për kompensim të shpërblimit jubile e parashtruar më datë 11.06.2024, është parashtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar më nenin 87 të LIGJI Nr. 03/L-212 i Punës.

Bazuar në konstatimet si më sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij, vendimi. Rrjedhimisht, aprovoj ankesën si të bazuar dhe detyroj Drejtorin e Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës që ankueses ti bëj kompensimin material të njohur sipas vendimit më numër protokolli 310, të datës 29.08.2025, të Menaxherit të Personelit të SHKK-së, sepse, siç u tha ma sipër ky akt është nxjerrë në pajtim më ligjin material.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1304/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses, G.M-K;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.